



Gesundheits-, Sozial- und Integrationsdirektion
Gesundheitsamt
Kantonsärztlicher Dienst

Drejtoria për shëndetësi, çështje sociale dhe integrim
Zyra e shëndetësisë
Shërbimi mjekësori i kantonit

Vaksinime të rekomanduara

Vaksinime të rekomanduara për fëmijë dhe të rinj në moshën shkollore (Kopshti i fëmijëve – Shkalla sekondare)

Mosha	Vaksinat
4-7 vjeç * nga 6 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> - Poliomieliti, difteria, tetanosi, kolla e bardhë, - *Encefaliti i rriqrave (FSME) <p>Vaksinimi i mëvonshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fruthi, shyta, rubeola
11-15 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> - Difteria, tetanosi, kolla e bardhë, - Hepatiti B (2 ose 3 doza) - Meningjiti bakterial (meningokokë) - Viruse papilloma humane (kanceri i qafës së mitrës, lythet gjenitale) (2 ose 3 doza) <p>Vaksinimi i mëvonshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Poliomieliti - Fruthi, shyta, rubeola - FSME

Nëse fëmija juaj është 11- deri 15-vjeç dhe nuk e ka kaluar akoma varicelën (li e zezë), ju duhet të bisedoni me mjeken tuaj të shtëpisë/mjekun tuaj të shtëpisë për një vaksinim të mundshëm kundër kësaj sëmundjeje infektive.

Ju lutemi vini re këto arsye të përgjithshme që mund të flasin kundër një vaksinimi:

- **Reaksione të mëparshme anafilatike (=reaksioni më i rëndë alergjik)**
- **Shtatzëni**
- **Dobësi të sistemit të imunitetit**
- **Sëmundje e rëndë akute**

Poliomieliti, difteria, tetanosi, kolla e bardhë,

Difteria

Kjo sëmundje fillon në shumicën e rasteve me dhimbje fyti. Në hundë dhe në qafë krijohen veshje, të cilat e pengojnë frymëmarrjen dhe e vështirësojnë frymëmarrjen ose e bëjnë atë të pamundur.

Për shkak të vaksinimit, në Zvicër, nuk shfaqen më sëmundje tipike të difterisë. Por shkaktari i sëmundjes ekziston megjithatë akoma, kështu që fëmijë jo të vaksinuar mund të infektohen në çdo kohë dhe mund të sëmurën rëndë.

Sharrëz (Tetanos)

Sharrëz krijohet nga një shkaktar, i cili ndodhet në tokë dhe në traktin e zorrëve të njeriut dhe të kafshëve. Ai depërton nëpërmjet lëndimeve (në plan të parë plagëve prerjeje dhe shpimi, djegiet) në trup. Helmi i tij e ngacmon sistemin nervor dhe shkakton spazma tepër të dhimbshme të muskujve.

Kollë e mirë (Pertussis)

Kjo sëmundje ngjitetëse bakteriale mund të shoqërohet nga atakë të kollitjes, frymëmarrja thithëse dhe të vjellë prej këlbazës dhe ushqimit. Sëmundja zgjat, si rregull, disa javë. Tek foshnjat mund të shfaqen komplikime si pneumoni, spazma ose bile dëmtime të përhershme të trurit. Tek një prej njëmijë foshnjave sëmundja përfundon me vdekje. Tek të rriturit komplikime të rënda ndodhin vetëm rrallë herë. Shpesh herë prindërit janë bartës të baktereve të kollës së mirë në foshnja dhe fëmijë dhe i infektojnë ata pa e ditur.

Paraliza e fëmijëve (Poliomyeliti)

Viruset polio i shkatërrojnë qelizat e sistemit nervor dhe shkaktojnë kështu paraliza në pjesë të

Kanton Bern Canton de Berne

ndryshme të trupit. Edhe muskulatura e frymëmarrjes mund të zihet, kështu që personi në fjalë ka nevojë për frymëmarrje artificiale. Gjymtyrët e prekur shpesh herë mbeten të dobësuar ose të paralizuar gjatë gjithë jetës.

Paraliza e fëmijëve falë disiplinës së mirë të vaksinimit në popullsi është praktikisht e zhdukur në Zvicër që nga viti 1983. Për ta ruajtur mbrojtjen duhet të vaksinohen të gjithë fëmijët edhe më tej.

Fruthi, shyta, rubeola

Këto tre sëmundje virale mund të çojnë në komplikime të rënda:

Fruthi	Pezmatim i trurit,
Shytat	Meningjiti, inflamacion i testikujve,
Rubeola	Rrezikimi i fëmijës së palindur, nëse sëmundja ndodh gjatë tre muajve të parë të shtatzënisë.

Fruthi, shytat dhe rubeola janë sëmundje ngjitëse, të shkaktuara nga viruse, kundër të cilave nuk ekziston asnjë trajtim specifik dhe të cilat shpesh herë konsiderohen të parrezikshme. Mund të shfaqin komplikime të rënda, të cilat shkaktajnë dëme të përhershme trupore ose mendore dhe në raste të rralla vdekjen. Vaksinimi është i vetmi mjet efektiv, për t'u mbrojtur kundër kësaj sëmundjeje.

Hepatiti B

Kjo sëmundje e zë mëlçinë. Shenja tipike është verdhëza. Ky infektim shpesh herë kalon pa u vënë re ose shfaqet vetëm me simptoma jo shumë tipike (dhimbje barku, ndjenjë e përzier, vjellje, lodhje, etj.). Hepatiti B akut kalon rrallë herë me vdekje. Shumica e personave të infektuar rimëkëmben pa pasoja. Por tek rreth 5-10% infektimi bëhet kronik, d.m.th. virusi mbetet përherë në trup. Këta persona mund ta përhapin virusin gjatë gjithë jetës dhe pas vitesh ose dekadash ata mund të sëmurën në një

tkurrje të mëlçisë (cirrozë) ose në kancer të mëlçisë. Hepatiti B transmetohet nëpërmjet gjakut dhe kontakteve seksuale.

Meningjiti bakterial (meningokokë)

Rreth 15 % e popullsisë mbajnë në zonën e hundës-grykës baktere të meningokokëve, pa u sëmurur. Por nëse bakteret nëpërmjet mukozës arrijnë në gjak, mund të ndodhin sëmundje të rënda. Meningjiti me qelb ose një helmim i gjakut përfshihen në sëmundjet më të frikshme. Sëmundjet e shkaktuara nga meningokokët janë të lidhura shpesh herë me komplikime. Me vaksinimin fëmija juaj është i mbrojtur në mënyrë optimale kundër sëmundjeve që shkaktohen nga meningokokët e grupeve A, C, W, Y (kundër të gjithë grupeve përveç grupit B).

Encefaliti i rriqrave (FSME)

Gjatë qëndrimit në natyrë rriqrat mund të transmetojnë shkaktarë të ndryshëm dhe mund të shkaktajnë kështu sëmundje të ndryshme. Dy më të rëndësishmet janë borrelia, edhe sëmundja lyme dhe meningoencefaliti i verës së hershëm (FSME).

Ndërsa sëmundja e parë mund të trajtohet me antibiotikë, për FSME nuk ka asnjë trajtim specifik. Vaksinimi mbrojtës kundër FSME është, krahas mbrojtjes së përgjithshme kundër rriqrave (p.sh. veshje të gjata), e vetmja zgjidhje praktike për persona, të cilët dëshirojnë të mbrohen në mënyrë të efektshme kundër FSME.

Kanceri i qafës së mitrës dhe lythat gjenitale

Rreth dyzet tipa të ndryshëm të viruseve papillo humane (HPV) transmetohen gjatë marrëdhënieve seksuale nga njeriu në njeri nëpërmjet kontaktit të lëkurës ose kontaktit me mukozat. Në shumicën e rasteve infektimi nuk sjell shqetësime, kështu që personi i prekur nuk vë re që ai është infektuar dhe

mund të transmetojë kështu HPV në persona të tjerë pa e ditur.

Tipat e ndryshëm HPV mund të shkaktajnë kancer (kancerin e qafës së mitrës / kancerin anal) ose lytha gjenitale. Meqë kanceri i qafës së mitrës, veçanërisht shkallët e tij paraprake janë të shpeshta dhe sëmundja është shumë serioze, vaksinimi HPV u rekomandohet vajzave si vaksinim i përgjithshëm.

Burrat vuajnë më rrallë nga sëmundjet e kancerit që janë shkaktuar nga HPV, por kanë aq shpesh si gratë lytha gjenitale. Prandaj vaksinimi HPV u rekomandohet edhe të gjithë djemve dhe burrave të rinj si vaksinim plotësues.

Komplikime nga vaksinimi

Shumë rrallë ndodh që komplikime të rënda shfaqen për shkak të vaksinimeve të përshkruara këtu. Të gjitha vaksinimet mund të çojnë në raste shumë të rralla në reaksione të rënda alergjike. Vaksina kundër fruthit, shytave, rubeolës është një vaksinë e gjallë dhe mund të çojë në raste tepër të rralla në inflamacione të nervave ose të trurit. Por këto komplikime janë shumë më të shpeshta në raste të sëmundjeve të kaluara (sëmundja e fruthit çon në rreth 1 për 1000 raste në një inflamacion të trurit).

Mirëpo këto efekte të lehta anësore shfaqin herë pas herë ose shpesh herë (në varësi nga vaksina):

- Ënjtje, dhimbje, skuqje rreth vendit të ngulitjes.
- Dhimbje koke, marrje mendsh, lodhje
- Dhimbje të muskujve / nyjave
- Ndjenjë e përzier, vjellje
- Simptoma të ngjashme me gripin